



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BELSH

**ADRESA:** BELSH

[bashkiabelsh@hotmail.com](mailto:bashkiabelsh@hotmail.com)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

29/07/2019

Belsh më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: B.O.E “Curri” Sh.p.k. & “BE-IS” Sh.p.k & “Ergi” Sh.p.k.

Adresa: Elbasan, Autostrada Elbasan-Metalurgji km 3.

\* \* \*

**Procedura e prokurimit:** Procedurë e Hapur.

**Numri i referencës së procedurës:** REF-23490-05-23-2019

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjeti shpërndarës i ujës jellësit për qytetin e Belshit”.

**Fondi limit:** 288346183 (dyqind e tetëdhjetë e tetë milion e treqind e dyzetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, sipas shkresës së Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, Agjensia Kombëtare e Ujësjetjes Kanalizime dhe Infrastruktura të Mbetjeve nr.1489 prot. date 17.05.2019 “Dergohet detajimi i buxhetit të viteve (2019-2021) për shpenzime kapitale, me financim të brendshëm, për programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, si dhe konfirmuar e autorizuar shpenzimi nga Dega e Thesarit Elbasan, date 25.07.2019 të urdherit të Prokurimit përkatës.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 120 ditë.

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):** Buletini i Njoftimeve Publike [27.05.2019] [21]

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara.

1. B.O.E Curri & BE-IS & Ergi

J67902718S & K71412003A & K02727229P

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera 287976685 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

*(me numra dhe fjalë)*

2. B.O.E Lala & B-93 & Arifaj & Arkonstudio J76418903B & J62903508R & J76418907K & L42019004I

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera 257899016.53 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtë mbëdhjetë presje pesëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

*(me numra dhe fjalë)*

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

B.O.E Lala & B-93 & Arifaj & Arkon Studio me nipt: J76418903B & J62903508R & J76418907K & L42019004I

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Përfundimin e vlerësimit pa një vendim përfundimtar për ofertën e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Lala” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k. & “Arifaj” sh.p.k. & Arkon studio sh.p.k. pasi me anë të shkresës nr. 76 datë 02.07.2019 me numër hyrës në institucion 2299 prot, datë 08.07.2019, me lëndë “Kërkesë për tërheqje...”, B.O.E ka paraqitur kërkesë për të mos marrë në shqyrtim ofertën e paraqitur duke u tërhequr nga pjesëmarrja në këtë procedurë. Nga shqyrtimi i kërkesës pranë Autoritetit Kontraktor, me anë të së cilës bashkimi i operatorëve

ekonomik kërkon të tërhiqet nga procedura e prokurimit objekt vlerësimi, Komisioni vëren se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Duke qenë se kjo situatë nuk rregullohet nga Ligji “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i drejtohet ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1, parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”. Komisioni gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomik është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt vlerësimi duke argumentuar veprimet e kryera për kërkesën në procesverbalin përkatës pjesë e procedurës, që sjell si pasojë mos shqyrtimin/vlerësimin e ofertës së tij nga Autoritetit Kontraktor. Heqja dorë nga pjesëmarrja në procedurë nga bashkimi i operatorëve ekonomik sjell si rrjedhojë përfundimin e vlerësimit pa një vendim përfundimtar për ofertën e paraqitur në këtë procedurë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [B.O.E “Curri” Sh.p.k. & “BE-IS” Sh.p.k & “Ergi” Sh.p.k.] me adresë Elbasan, Autostrada Elbasan-Metalurgji km 3,se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [287976685 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Belsh, Njësisë së Prokurimit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.07.2019

Ankesa: Jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
K R Y E T A R I**

**Arif TAFANI**